




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <b>2-D/DPK</b>	Nr Prot. Br. Prot. <b>01-4129/13</b>
Nr. lfaq. Broj stranica Nr. pages <b>02</b>	Data Datum Date <b>02.12.2013</b>
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.11.2013, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-3046/13, për znj. Myrvete Paçarada – U. D. Drejtor në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike, për arsye se e njëjta ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-3046/13, për zyrtaren e lartë znj. Myrvete Paçarada – U. D. Drejtor në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike, dhe njëkohësisht pronare në biznesin privat O.GJ.O. “Gynekos”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Në këtë rast, zyrtarja e lartë znj. Paçarada është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e saj publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtarja në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Në këtë takim ajo ka konfirmuar se në cilësinë e zyrtares të lartë e ushtron funksionin e U. D. të Drejtorit në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike, dhe njëkohësisht është pronare në biznesin privat O.GJ.O. “Gynekos”.

Zyrtarja e lartë publike ka kuptuar situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, prandaj pas rekomandimit të Agjencisë, ka premtuar se do të autorizoj një person të besueshëm që të udhëheq kompaninë.

Pas kësaj, znj. Paçarada, ka dërguar informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve (DPKI 03-3783/13) në të cilën vërtetohet se e njëjta ka autorizuar një person të besueshëm për udhëheqjen e këtij biznesi.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatohet se është shmangur situata e mundshme të konfliktit të interesit.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

